



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 231P Prot.

Tiranë, më 10.09.2025

VENDIM

Nr. 271, datë 04.09.2025

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR ZHVILLIMIN E
PROCEDURËS SË RIVLERËSIMIT KALIMTAR PËR SUBJEKTIN ANTON PALI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 04.09.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“ Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për zhvillimin e procedurës së rivlerësimit
kalimtar për subjektin Anton Pali”***

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

V Ë R E N:



1. Subjekti i rivlerësimit Anton Pali ka ushtruar detyrën e magjistratit prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (aktualisht ushtron detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës), deri më datë 10.04.2024, ndërkohë që me vendim (të ndërmjetëm) Nr. 4, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur pezullimin nga detyra të subjektit për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Në përfundim të Programit të Trajnimit për vitin akademik 2024-2025, me shkresën nr. 937 prot. dt. 15.07.2025, Shkolla e Magjistraturës ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Vëzhguesit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Komisionerin Publik mbi rezultatet e provimit përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë subjektin Anton Pali, ndërkohë që për dijeni është njoftuar edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
3. Me aktin e lartpërmendur, Këshilli njoftohet, ndër të tjera se, referuar përcaktimeve ligjore të shprehura në nenin 60, të Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka ndjekur rregullisht shkollën duke filluar nga data 17.11.2024 deri në përfundimin e vitit akademik.
4. Konkretisht, z. Pali ka zhvilluar gjashtë lëndë me koeficientin 1.5 të vlerësimit dhe një lëndë me koeficientin 1 të vlerësimit.
5. Në vijim të sa më sipër, si dhe konform parashikimeve të Nenit 45/1, “Vlerësimi për magjistratët të cilët do të ndjekin për një vit Programin e Formimit Fillestar, bazuar në vendimin e institucioneve të rivlerësimit”, të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, e ndryshuar, si dhe planin mësimor, z. Anton Pali është vlerësuar gjithsej me 85.72 pikë, të cilat janë 85.72 % sipas vlerësimit me shkallë, ndërkohë që vlerësimi me nivele i korrespondon rezultatit “Mirë”.
6. Përfundimisht si dhe referuar vlerësimit të lartpërmendur, Shkolla e Magjistraturës informon se, subjekti i rivlerësimit Anton Pali ka kaluar me sukses Programin e Formimit sipas ligjit.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

7. Me përfundimin e mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë legjitimohet të zhvillojë procedurën objekt i këtij vendimi, bazuar dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 8, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën parashikohet ndër të tjera se *çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit.*

- 
8. Bazuar në nenin 5, pika 1, të Rregullores “Mbi zhvillimin e procedurave për rivlerësimin e subjekteve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, ku parashikohet se: “Për zhvillimin e procesit administrativ (hetimit), do të ngrihet për secilën çështje një Komision i Përkohshëm për rivlerësimin kalimtar, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 2 (dy) anëtarë prokurorë dhe 1 (një) anëtar joprokuror, të zgjedhur në mënyrë rastësore, me short, nga anëtarët e Këshillit.....”, Këshilli merr vendimin përkatës me qëllim ngritjen e Komisionit të Përkohshëm, përbërja e të cilit caktohet me short në mënyrë rastësore, konform kriterëve të mësipërme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 179/b, pika 8, të Kushtetutës, Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 1 – 4, 5, pika 1 dhe 14, të Vendimit nr. 169 dt. 16.07.2025, “Për miratimin e Rregullores “Mbi zhvillimin e procedurave për rivlerësimin e subjekteve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për zhvillimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar për subjektin Anton Pali.
2. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm caktohet nëpërmjet procedurës së shortit, si vijon:

i. Z. Sokol Stojani	Anëtar Prokuror
ii. Znj. Ledina Riza	Anëtar Prokuror
iii. Z. Erion Fejzulla	Anëtar Joprokuror
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 04.09.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ZV/KRYETAR

Erind Germenji

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Erion Fejzulla

KOPJE WEB